



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada - Government**

**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare**

---

**Prishtinë, 06.04.2018**

**Për: SHTZ Ramush Haradinaj.....Kryeministër i Republikës së Kosovës**

**Cc: Skënder Reqica.....Ministër i MPMS**

**Nga: Çerkin Dukolli.....Zv. Ministër i MPMS**

**Tema: Raporti 100 ditor i punës ( 03.01- 06.04.2018) si Zëvendës Ministër në MPMS**

**I nderuar z. Kryeministër**

Më lejoni, që përmes këtij raporti në formë të shkruar të paraqes punën time 100 ditore si Zëvendës Ministër në MPMS.

**Nga ministri Skender Reqica jam i ngarkuar të ndihmojë stafin në hartimin e akteve ligjore, Inspektoratin e Punës dhe Zyrën e TMK-së.**

**Me vendim të Qeverisë nr.10/26 i dt.29.01.2018 jam emëruar Kryesues i Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në punë (KNSSHP)**

**I. Aktivitetet operative:**

**1. Me dt.03.01.2018** me kërkesë timen, kam takuar Kryeinspektorin e Punës z. Basri Ibrahim, kam vizituar ambientet e punës, jam njohur me punën e kësaj trupe inspektuese, aktivitetet e tyre gjatë vitit 2017, planifikimin për vitin 2018, gjithsesi kemi debatuar për respektimin e Ligjit të punës, respektimin e Ligjit për siguri dhe shëndet në punë, si në institucionet publike po ashtu edhe në ndërmarrjet private.

Në këtë takim kërkoja që të bëjmë një plan të menjëhershëm dhe ti vizitojmë zyrat e inspektoratit në shtatë (07) regjionet e vendit.

**2. Me dt. 04.01.2018** kam takuar në një takim drejtuesit e Zyrës për Çështje trashëgimore të TMK, z. Safet Sylja me bashkëpunëtor.

U interesova për gjendjen e ish pjesëtareve të TMK-së dhe ecurinë e pensionimit e tyre deri ku ka shkuar. Deri në këto momente janë pensionuar 1036 pjesëtar, ndërsa presin moshën e pensionimit edhe 520 të tjerë. Temë diskutimi dhe kërkesë e ZÇT TMK-ishte që të gjithë shfrytëzuesve të pensionit të TMK-së, mos tu mohohet e drejta që të jene edhe përfitues të pensionit të invalidit të luftës, që deri me tani këtë pension brenda pensionisteve të TMK-së e

shfrytëzojnë 220 persona. U informuam që kjo zyre dosjet e TMK-se i ka vendosur ne Arkivin shtetëror të Kosovës.

**3. Me dt.05.01.2018**, kam takuar inspektorët e punës në Regjionet Gjakovë dhe Prizren. Jam njohur nga afër me punën që bëjnë këta inspektorë, me kushtet e punës etj. Ajo çka vlen të theksohet është se në këto regjione respektohen vendimet e inspektorëve, si në sektorin publik po ashtu edhe në sektorin privat, gjithsesi tema që ka dominuar ka qenë siguria dhe shëndeti në punë.

Ka mungesë të numrit të inspektorëve, Gjakova ka 3 (tre) ndërsa Prizreni vetëm 4 (katër) inspektor pune.

**4. Me dt.10.01.2018**, kam takuar inspektorët e punës në Regjionet Ferizaj dhe Gjilan.

Jam njohur nga afër me punën që bëjnë këta inspektorë, me kushtet e punës etj. Vlen të theksohet është se në këto regjione respektohen vendimet e inspektorëve, si në sektorin publik po ashtu edhe në sektorin privat, gjithsesi tema që ka dominuar ka qenë siguria dhe shëndeti në punë. Ferizaj ka pese (5) ndërsa Gjilani shtatë (7) inspektor.

**5. Me dt.17.01.2018** kam takuar inspektorët e punës në Regjionin e Pejës. Jam njohur nga afër me punën që bëjnë këta inspektorë, me kushtet e punës etj. Në këtë regjion respektohen vendimet e inspektorëve, si në sektorin publik po ashtu edhe në sektorin privat, gjithsesi tema që ka dominuar ka qenë siguria dhe shëndeti në punë.

Peja ka shtatë (7) inspektor. Sektori më i rrezikuar mbetet ndërtimtaria. sa i përket sigurisë në punë.

**6. Me dt.18.01.2018** kam takuar inspektorët e punës në Regjionin e Prishtinës. Jam njohur nga afër me punën që bëjnë këta inspektorë, me kushtet e punës etj. Në këtë regjion respektohen vendimet e inspektorëve, si në sektorin publik po ashtu edhe në sektorin privat, gjithsesi tema që ka dominuar ka qenë siguria dhe shëndeti në punë.

Prishtina ka gjashtëmbëdhjetë (16) inspektor. Sektori më i rrezikuar mbetet ndërtimtaria sa i përket sigurisë në punë, gjatë vitit 2017 në këtë regjion ka pasur rreth 3200 inspektime, disa lëndime në punë , 5 raste me fatalitet të cilat kanë ndodhur në ndërtimtari.

**7. Me dt.09.02.2018** kam takuar inspektorët e punës në Regjionin e Mitrovicës. Jam njohur nga afër me punën që bëjnë këta inspektorë, me kushtet e punës etj. Ajo çka vlen të theksohet është se në këtë regjion respektohen vendimet e inspektorëve, si në sektorin publik po ashtu edhe në sektorin privat, gjithsesi tema që ka dominuar ka qenë siguria dhe shëndeti në punë.

Mitrovica ka katër (4) inspektor. Sektori më i rrezikuar mbetet ndërtimtaria sa i përket sigurisë në punë.

**Si përfundim:**

Punëtoret po pajisen më kontrata pune, në të shumtën e rasteve, jo formaliteti ka rënje.

Siguria në punë po shkon drejt përmirësimit të dukshëm.

Vendimet e inspektorëve respektohen edhe në sektorin privat edhe në atë publik.

Numri i inspektorëve është i vogël, në disa raste inspektorët janë të moshuar dhe më shëndet jo të mirë.

Paga e tyre në raport me punën dhe përgjegjësit që kanë është tepër e vogël ( koeficienti 7).

## **II. Aktivitetet legjislativ:**

1. Kam mbikëqyrë punën e grupit punues për hartimin e **Projektligjit të ri për Inspektoratin e Punës**. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi mbajtur disa takime dhe një punëtori me grupin punues dhe kemi ardhur deri te drafti final. Punëtorja finale është mbajtur me dt.08.02.2017, tanimë ky projektligj është në diskutim publik.

2. Koncepti i dokumentit të Projektligjit të punës, në diskutim publik, do vazhdohet me hartimin e projektligjit.

## **III. Aktivitetet MPMS & organizata tjera**

1. Me dt.06.2017 në Shkup është mbajtur konferenca e parë rajonale për **“Ekonominë e fshehur”**, organizuar nga tre institutet CRPP (Maqedoni) IDM (Shqipëri) dhe D4D (Kosovë). Në këtë konferencë kam përfaqësuar MPMS dhe kam mbajtur fjalim lidhur me angazhimet tona në luftimin e ekonomisë joformale, konkretisht kam folur lidhur me luftimin e punësimeve joformale, ngase janë në domenin e inspektoratit të punës.

2. Me dt. 16.02.2018 në cilësinë e kryesuesit kam thirrur takimin e Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (KNSSHP) bazuar në vendimin e qeverisë nr.05/2018 të dt.05.10.2016. Në takim kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e KNSSHP (dhjetë anëtarët) dhe që në takimin e parë jemi dakorduar që menjëherë të hartohet plani vjetor i punës së këtij këshilli dhe me urgjencë tu bëhet vizitë: Institutit të Mjekësisë së Punës (IMP) në Obiliq dhe Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës (QKMP) në Gjakovë, për tu njoftuar me punën, statusin juridik të tyre dhe shërbimet që ato ofrojnë.

3. Me dt.21.02.2017 kam realizuar një takim me zv. **Ministren e MKRS znj. Burbuqe Deva Bakija**, lidhur me dhënien në dispozicion të një këndi ekspozues të përhershëm nga Muzeu u Kosovës për Zyrën për Çështje Trashëgimore të TMK-së e cila funksionon në kuadër të MPMS. Marrja e këtij këndi nga Muzeu u Kosovës për ZÇTTMK-së është me rëndësi të madhe, ngase aty mendohet të dërgohet dhe të ruhet trashëgimia 10 vjeçare e TMK-së (eksponate si flamuj, stema të njëjësive, dokumentacione të ndryshme etj). U pajtuam që të vazhdojmë këto takime me përfaqësues të muzeut dhe ZÇTTMK-së edhe në të ardhmen.

4. Me dt.27.02.2018, kam pritur në takim Sekretarin e Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës z. Esat Kelmendi. Temë e takimit ishte kërkesa nga UP-ja, që MPMS përmes programeve të veta që të ndihmojë në punësimin e një numri të studentëve absolutë në programin praktikë institucionale dhe për këtë kërkoj që të krijojmë një marrëveshje dypalëshe.

Me këtë rast z. Kelmendi njoftoj se UP edhe më parë ka realizuar këso lloje programesh me disa nga resorët qeveritare.

U pajtuam që UP-ja të bëjë kërkesën me shkrim dhe më pas, ne si Ministri të shqyrtojmë mundësitë tona përkrahëse.

5. Me dt.28.02.2018 kam pritur në takim Kryetarin e Komunës së Hanit të Elezit, z. Rufki Suma cili u interesua për qështje e bartjes së pronësisë të objektit për punë sociale (financuar më parë nga MPMS dhe një pjesë nga komuna).

E njoftova Kryetarin Suma që kjo punë është në procedurë dhe në afatin sa më të shpejtë qështja e pronësisë për të dy etnitetet do të s'qarohet. Për këtë qështje Sekretari i Përgjithshëm MPMS i

cili ishte i pranishëm në takim u zotua se do ti marrë veprimet e nevojshme dhe tanimë kjo qeshtje është kryer.

**6. Me dt.02.03.2016** anëtarët e KNSSHP kanë vizituar IMP Obiliq dhe Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së punës në Gjakovë.

Lidhur me këtë vizitë anëtarët e KNSSHP kanë hartuar një raport enkas për Qeverinë (Kryeministrin) , të cilin edhe e kemi dërguar.

KNSSHP është në fazën e hartimit të planit të punës dhe në baza periodike do t'i raportoj Qeverisë për punën e tij.

**7. Me dt.16.03.2016**, KNSSHP ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën janë trajtuar dy qeshtje: raporti i këtij këshilli i përgatitur për Qeverinë pas vizitave të bëra në dy institutet e mjekësisë së punës dhe përpilimi i planit të punës së këshillit.

Në këtë mbledhje raporti për Qeverinë u votua unanimisht, dhe me këtë datë ky raport në kopje fizike është adresuar për Kryeministrin , në vëmendje për Ministrin e MPMS dhe Ministrin e Shëndetësisë.

**8. Me dt.22.03.2018**, kam marrë pjesë në cilësinë e panelistit në “ Tryezën për mbrojtje dhe siguri në punë “ organizuar nga BSPK-ja.

**9. Me dt.04.04.2018** kam marrë pjesë si panelist në eventin e D4D në temën ” Leja prindërore. Pikënisje për riformësimin e tregut të punës?” së bashku me ambasadorin suedez z. Henrik Nilsson dhe panelistë tjerë, ku diskutuam rrethë propozim ndryshimeve të reja qe kanë të bëjnë me Ligjin e Punës.

#### **IV. Prezantime në media:**

Shkrime në disa portale rreth angazhimeve në MPMS.

Me dt.11.01.2018 intervistë në TV. Tribuna Channel, tema angazhimet në MPMS.

Me dt.23.01.2017 intervistë në RTV21, rreth temës angazhimet e zv. Ministrave.

Konferencën rajonale “Ekonomia e fshehur”, Shkup- panelist.

Aktivitetet e KNSSHP.

Tryeza për Mbrojtje dhe siguri në punë, BSPK- panelist etj.

Diskutimi ne D4D ne temën” Leja prindërore. Pikënisje për riformësimin e tregut të punës?” panelist.

**V. Të tjera:** Vizita, takime të ndryshme, etj.

**Me respekt!**